1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Data _____	

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nëshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmblidhjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

A. MATERIALE NDËRTIMORE

1. Bravë durali 30 mm + doreza alumini + fishekë 7cm

Bravë metalike, e përshtatshme për dyer të brendshme, rezistente ndaj angjentëve të tjerë kimikë. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Përmasat 30*30 mm. Fisheku të jetë cilindër me gjatësi 7 cm.

2. Bravë horizontale + doreza alumini + fishekë

Bravë metalike, te jetë e përshtatshme për t'u vendosur në pozicion horizontal, kyçje qendrore me çelës, rezistente ndaj agjentëve të tjerë kimikë. Hapja dhe mbyllja me dorezë material alumini dhe gjuhëz trapezoidale, fisheku të jetë cilindër standart 7-9 cm.

3. Bravë 40*85 + doreza + fishekë 7cm

Bravë metalike, e përshtatshme për dyer të brendshme, rezistente ndaj agjentëve të tjerë kimikë. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Përmasat 40*85 mm. Fisheku të jetë cilindër me gjatësi 7 cm.

4. Bravë 50*70 e thjeshtë + doreza

Përmasat 50*70 mm, për dyer të brendshme. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Lloji i kyçjes të jetë me gjuhëz me çelës të thjeshtë minimumi me dy hapje.

5. Bravë me sferë 30 mm + fishekë 9cm

Përmasat 30*30 mm, për dyer të brendshme, fisheku të jetë cilindër me gjatësi 9 cm.

6. Bravë durali 35 mm + doreza alumini + fishekë 7 cm

Bravë metalike, e përshtatshme për dyer të brendshme, rezistente ndaj agjentëve të tjerë kimikë. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Përmasat 35*35 mm. Fisheku të jetë cilindër me gjatësi 7 cm.

7. Brave hekuri 20mm + doreza + fisheke 7cm

Trup bravë çelik i galvanizuar, cilindër standard 7 cm, për dyer industriale.

8. Brave hekuri 20mm + doreza + fisheke 9cm

Trup bravë çelik i galvanizuar, cilindër standard 9 cm, për dyer industriale.

9. Brave 50*85 + doreza + fisheke 7 cm

Bravë metalike, e përshtatshme për dyer të brendshme, rezistente ndaj agjentëve të tjerë kimikë. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Përmasat 50*85 mm. Fisheku të jetë cilindër me gjatësi 7 cm.

10. Bravë 50*90 e thjeshtë + doreza

Përmasat 50*90 mm, për dyer të brendshme. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Lloji i kyçjes të jetë me gjuhëz me çelës të thjeshtë minimumi me dy hapje.

11. Bravë 40*70 e thjeshtë + doreza

Përmasat 50*90 mm, për dyer të brendshme. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Lloji i kyçjes të jetë me gjuhëz me çelës të thjeshtë minimumi me dy hapje.

12. Bravë me fishekë 50*90 + doreza rozetë + fishekë 7 cm

Përmasat 50*90 mm, për dyer të brendshme. Hapja dhe mbyllja me dorezë dhe gjuhëz trapezoidale. Lloji i kyçjes të jetë me gjuhëz me çelës të thjeshtë minimumi me dy hapje. Dorezë rozetë të jetë material çelik dhe të ketë të përfshira të ndara dy rozeta në formë cilindrike për dorezën dhe për vrimën e çelësit sëbashku me aksesoret e montimit.

13. Menteshë durali e thjeshtë superluce

Materiali të jetë prej çeliku.

14. Mentsha fletore 10 cm

Materiali çelik inox AISI 304, gjatësi 100 mm, trashësi fletë 2 mm.

15. Mentsha durali me hedhje

Materiali të jetë prej çeliku.

16. Mentsha durali e thjeshtë

Materiali të jetë prej çeliku.

17. Monteshe 3-she per pesha te renda

Materiali të jetë prej çeliku i galvanizuar, për dyer ≥ 100 kg. Bosht Ø10 mm, fletë të përforcuara.

18. Doreza durali spajolete me mekanizem superluce

Dorezë spajolete + kit për montimin e dorezës, dorezë me mekanizëm të heshtur dhe rrotullim të butë. Përdorim për dyer të brendshme, anodizuar, Ø rozete 50 mm.

19. Doreza durali me kunjja

Montim nëpërmjet boshtit qendror me kunjë 8x8 mm, përputhje me shumicën e bravave Euro-profile.

20. Doreza alumini me levë

Lëvizje vertikale me levë. Për dyer me mentesha të buta ose automatike.

21. Doreza durali spajolete

Model klasik me rrotullim 90°. Përshtatje për dyer me trashësi 35-50 mm. Bosht çeliku, trup alumini.

22. Doreza durali me levë

Lëvizje e shpejtë dhe e qetë për hapje të brendshme. Bosht inox, dizajn minimalist.

23. Doreza durali (alumini)

Materiali alumin, te jete e pajisur me dy vrima m5 per kapjen e tyre ne trup te deres. Rezistente ndaj agjenteve kimikë.

24. Shul dere durali 30 cm

Materiali çelik, përmasat 30 cm, ngjyra gri.

25. Shkume dere 750 ml

Material njëkomponentësh poliuretani, paketimi 750 ml. Temperatura optimale e shkumës para përdorimit është +15 deri në +35° C. Temperatura minimale e ambientit është +5°C. Lagia intensive është e domosdoshme nëse lagështira e ajrit është nën 35%. Koha e tharjes 60-90 min, tharje maksimale 12 orë. Zgjerimi 30-50x. Dendësia të jetë 10-15 kg/m². Rezistente ndaj mykut, ujit dhe nxehtësisë.

26. Gomina xhami 6mm

Gjerësia 6mm, material PVC/EDM, izolues uji.

27. Gomina xhami 8mm

Gjerësia 8mm, materiali me fije prej PP me silikon ose ekuivalent, aplikime në dritare d/al

28. Gomina xhami 14mm

Gjerësia 14mm, materiali me fije prej PP me silikon ose ekuivalent, aplikime në dritare dopio xham

29. Ristela 85*5*3 cm

Dërrasë e cilësisë së parë, rezistente ndaj temperaturës dhe lagështisë, përmasat sipas preventivit, gjatësia 85 cm.

30. Ristela 85*5*3 cm

Dërrasë e cilësisë së parë, rezistente ndaj temperaturës dhe lagështisë, përmasat sipas preventivit, gjatësia 85 cm.

31. Silikon transparent

Silikon me bazë acetik për përdorim të përgjithshëm, përdorimi në dru, mure, shkallë, mermer, pvc. Të jetë rezistent në temperaturën -të ulta dhe të larta, rezistent ndaj ujit. Paketimi 280-320ml.

32. Silikon mbushes 450g

Silikon me bazë akrilik për përdorim të përgjithshëm, përdorimi në dru, mure, shkallë, mermer, pvc. Të jetë rezistent në temperaturën -20° - +60°, rezistent ndaj ujit. Paketimi 280-320ml.

33. Xham normal

Xham pa model, përdorim standart në dritare, i papërpunuar. Trashësia e xhamit transparent të jetë 4mm. Përmasat sipas preventivit. Xham i temperuar.

34. Xham me lule

Xham dekorativ, me model të printuar apo të gdhendur, përdorim estetik, trashësia e xhamit 4-6 mm, përmasat sipas preventivit. Xham i temperuar.

35. Dryn

Trupi i drynit të jetë prej bronzi, kurse harku mbyllës prej çeliku special me diametër $\Phi 35-40\text{mm}$. Të ketë minimumi 3 çelësa.

36. Gone per dere durali italian

Bashkuese këndore 90°, materiali alumin.

37. Bojë hidromat

Mbulimi: 11 m², në sipërfaqe të përgatitur më parë

Paketimi: 9l

Hollimi: Me 10-20% ujë të pastër

Koha e tharjes: Rilyerja 3-4 orë (në kushtë atmosferike të përshtatshme +10°- +35°)

38. Stuko

Stuko patinimi është e përbërë nga çimento e bardhë, gëlqere e hidratuar, pluhur mermeri i bardhë, rezinë dhe aditivë specialë.

Paketimi: 15 kg

Raporti përzierjes: 4.5 – 5 litra ujë për 1 paketim

Temperatura e punës: +5° deri në +35°

39. Fino e bardhë

Fino e bardhë është e përbërë nga çimento, gëlqere e hidratuar, rërë guri karbonik dhe mermer me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditivë special.

Përdorimi: I përshtatshëm për realizimin e rifiniturave të sipërfaqeve të mbushura me llaç tradicional.

Paketimi: 25 kg

Raporti i përzierjes: 7.5 – 8 litra ujë për 1 paketim

Temperatura: +5° deri në +35°

Forma: Pluhur

Konsumi: 2-2.3 kg/m²

40. Pigment

Të shpërndahet lehtësisht dhe të ketë fuqi të madhe lysterje. Paketimi 0.75l. Ngjyrat sipas preventivit.

41. Bojë vaji e zezë

Përdoret për lysterjen e sipërfaqeve metalike dhe siguron mbrojtje nga korrozioni. Të jetë rezistente ndaj agjentëve atmosferikë dhe kimike.

Paketimi: 0.75l

Hollimi: me 25 % ujë

Koha e tharjes: 30 min, Dora e dytë pas 16 orësh

Mbulimi: 12-14 m²

42. Gips çimentato

Gips çimentato e përbërë nga çimento Portland dhe e përforcuar me rrjetë me lesh xhami që e bën më të qëndrueshme dhe me rezistente. Trashësia e pllakës 8mm, pesha 10.5 kg/m², përçueshmëria termike l: 0.36 Ë/mk, rezistenca ndaj avullit m:40, përmasat sipas preventivit.

43. Vida gipsi

Materiali çelik i zinkuar, vida gipsi me bullon.

44. Vida druri

Materiali çelik i zinkuar për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm, përmasat sipas preventivit.

45. Vida vetshpuesë kokë çadër

Materiali çelik i zinkuar për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm, përmasat sipas preventivit.

46. Lavaman porcelani

Materiali: Porcelan

Ngjyra: e bardhë

Mënyra e montimit: Në tokë

Përmasat: 55*45 cm

Përmasat e akseve: 20 cm

47. Kasetë WC porcelani

Materiali: Porcelan

Ngjyra: e bardhë

Kapaciteti mbajtës: 6-9 litra

Montimi: Muror

48. Kasetë WC plastike

Materiali: ABS Plastik

Ngjyra: e bardhë

Kapaciteti mbajtës: 6 litra

Montimi: Muror/ Sipërfaqësor

49. Tub fleksibël F-F 70 cm Ø1 e ½

Material: Inoks

Lidhja: Femër-Femër

Gjatësia: 70 cm

50. Mekanizëm kasete plastike

Mekanizëm lëshimi dhe valvul pllakë, të përshtatet për kaseta standarte, të përfshira dhe aksesoret e fiksimit, ngjyra e bardhë, materiali plastik, lidhja me rrjetin 3/8".

51. Mekanizëm kasete porcelani

Mekanizëm kompleks me flotator dhe valvul qëndrore.

52. Saraqineske

Tipi: Krahë

Trupi: Inoks

Lidhje: ½"

53. Rubinete bronzi

Material: Bronz

Tipi: një ose dy doreza

Lidhja: ½" F

54. Grup lavamani

Përfshin rubinetë, sifon dhe tub lidhës, materiali inoks.

55. Gomina WC tokesor

Materiali Gomë EPDM me diametër Ø100 mm.

56. Fleksibël grupesh

Gajtësi 30-50 cm, materiali është çelik + vulë gomë.

57. Priza shuko 16A 220-240V GEWISS ose ekuivalent

Tension: 220-240 V AC

Rryma: 16 A

Montim: Mural

Materiali: plastik

58. Çelës 1P 10A GEWISS ose ekuivalent

Rryma: 10 A

Materiali: plastik

Tipi: I thjehstë për ndriçim

59. Suport 3P (Gewiss ose eq.)

Materiali plastik me 3 module, përshtatet me korniza geëiss.

60. Kapak 3P (Gewiss ose eq.)

Kornizë me 3 module, materialai: termoplastik, ngjyra e bardhë.

61. Tap fallco (Gewiss ose eq.)

Mbulesë për module bosh, materiali plastik.

62. Llamba 12-18W, 230V, E27

Llampa duhet të jetë e tipit LED. Duhet të ketë zokol të tipit **E27**. Transmetimi i dritës duhet të jetë uniformë, të ketë kënd shpërndarje të dritës 360° dhe me temperaturë ngjyre nga 6000-6500K. Të jetë lehtësisht i montueshëm. Llampa duhet të jetë e çertifikuar sipas normave europiane dhe të permbajë markën CE.

63. Portollambë E27, 10A e zezë

Material: Plastik rezistent ndaj nxehëtisë, ngarkesa deri në 10A.

64. Limitator Mag. Ter. 1P 10A/20A/25A

Tip: MCB(Miniature Circuit Breaker)

Njëpolësh

Kapaciteti: 6kA

65. Neone 1.20 m 220V

Tipi: Tub LED T8

Gjatësi: 120 cm

Tension: 220 V

Fuqi: 18Ë-22W

66. Panel katror 59.5x59.5x1.2cm 40W

Ndriçuesi duhet të jetë i teknologjisë LED dhe të ofrojë fluks të ndriçimit ≥ 3200 lumen. Struktura duhet të jetë e përbërë prej material alumini dhe plastike, të ketë shkallë mbrojtje të paktën IP20. Transmetimi i dritës duhet të jetë uniforme, dhe me temperaturë ngjyre jo me

shumë se 6000-6500 K. Të jetë lehtësisht i montueshëm në panel gipsi dhe të ofrojë mundësi manovrimi sipas nevojave. Trupi ndriçues duhet të jetë i çertifikuar sipas normave europiane dhe të përmbajë markën CE.

Fuqia [W]: 40 W

Fluksi i ndricimit [lm] : ≥ 3200 lm

Klasi i mbrojtjes [IPXX]: IP20

Tensioni i ushqimit [V]: 220 – 240 V

Frekuenca e funksionimit [Hz]: 50Hz

Materiali: alumin , plastik

Ngjyra e trupit: bardhë

Temperatura e dritës [K]: 6000-6500 K

Jetëgjatësia mesatare [h]: $>28\,500$

Klasa e efikasitetit të energjisë: A++

Përmasat [cm]: 59.5x59.5x1.2

67. Spot katror LED mur 30W, 30x30cm

Ndriçuesi duhet të jetë i teknologjisë LED. Struktura duhet të jetë e përbërë prej materiali alumini dhe plastike, të ketë shkallë mbrojtjeje të paktën IP20. Transmetimi i dritës duhet të jetë uniformë dhe me temperaturë ngjyre 6000-6500K. Të jetë lehtësisht i montueshëm në mur dhe të ofrojë mundësi manovrimi sipas nevojave. Duhet të ketë dimension të jashtëm 30 cm dhe dimension të brendshëm 27cm. Trupi ndriçues duhet të jetë i çertifikuar sipas normave europiane dhe të përmbajë markën CE. Të jetë i lehtë në çmontim dhe montim në momentet që kërkohet të bëhet mirëmbajtje.

Fuqia [W]: 24 W

Tensioni i ushqimit [V]: 220 – 240 V

Frekuenca e funksionimit [Hz]: 50Hz

Materiali: alumin , plastik

Ngjyra e trupit: bardhë

Temperatura e dritës [K]: 6000-6500K

Jetëgjatësia mesatare [h]: $>30\,000$

Klasa e efikasitetit të energjisë: A++

Përmasat [cm]: forma katrore, dimension 30*30

68. Tel elektrik

Seksion 1.5mm², 2.5 mm², 4mm²

Izolimi: PVC

Ngjyrat sipas preventivit

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

1. Materiale ndërtimore

Nr.	Nr. Anl	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia
1	treg	Çimento 32.5N	kg	705
2	treg	Rere e lare lavatrice	m3	10
3	An	Llaç-çimento 1:3	m3	5
4	An	Granil guri	m3	10
5	treg	Brave durali 30 mm + doreza alumini + fisheke 7cm	cope	28
6	treg	Brave horizontale + doreza alumini + fisheke	cope	29
7	treg	Brave 40*85 + doreza + fisheke 7cm	cope	7
8	treg	Brave 50*70 e thjeshte + doreza	cope	25
9	treg	Brave me sferë 30 mm + fisheke 9cm	cope	1
10	treg	Brave durali 35 mm + doreza alumini + fisheke 7 cm	cope	7
11	treg	Brave hekuri 20mm + doreza + fisheke 7cm	cope	4
12	treg	Brave hekuri 20 mm + doreza + fisheke 9 cm	cope	2
13	treg	Brave 50*85 + doreza + fisheke 7 cm	cope	29
14	treg	Brave 50*90 e thjeshte + doreza	cope	2
15	treg	Brave 40*70 e thjeshte + doreza	cope	8
16	treg	Brave me fisheke 50*90 + doreza rozete + fisheke 7 cm	cope	33
17	treg	Menteshe durali e thjeshte superluce	cope	46
18	treg	Mentesha fletore 10 cm	cope	24
19	treg	Mentesha durali me hedhje	cope	26
20	treg	Mentesha durali e thjeshte	cope	12
21	treg	Menteshe 3-she per pesha te renda	cope	28

22	treg	Doreza durali spajolete me mekanizem superluce	cope	26
23	treg	Doreza durali me kunja	cope	6
24	treg	Doreza alumini me leve	cope	8
25	treg	Doreza durali spajolete	cope	4
26	treg	Doreza durali me leve	cope	10
27	treg	Doreza dere durali (alumini)	cope	38
28	treg	Shul dere durali 30 cm	cope	4
29	treg	Shkume dere 750 ml	cope	30
30	treg	Gomina xhami 3mm	kg	1
31	treg	Gomina xhami 6mm	kg	18
32	treg	Gomina xhami 8mm	kg	14
33	treg	Gomina xhami 14mm	kg	4
34	treg	Ristela 140*8*3	cope	16
35	treg	Ristela 85*5*3 cm	cope	24
36	treg	Ristela 80*3*3 cm	cope	22
37	treg	Silikon transparent	cope	30
38	treg	Silikon mbushes 450g	cope	20
39	treg	Xham normal 82*65 cm	m2	5
40	treg	Dryn	cope	5
41	treg	Stuko	kg	50
42	treg	Fino e bardhe	kg	200
43	treg	Koka Kacavide PZ2	cope	10
44	treg	Koka kacavide PH2 ose ekuivalent S2T25	cope	10
45	treg	Upa Ø8	cope	60
46	treg	Vida 6*80	cope	100
47	treg	Vida 6*80	cope	60
48	treg	Vida druri 4*25	kuti	2
49	treg	Vida druri 4*18	kuti	1
50	treg	Vida druri 4*30	kuti	1
51	treg	Vida druri 4*40	kuti	1
52	treg	Vida filetanto koke çader 4*30	kuti	2
53	treg	Vida filetanto koke çader 4*20	kuti	2
54	treg	Gone metalike 30mm * 30mm	kuti	7
55	treg	Vinovil	liter	7
56	treg	Gozhde 2 cm	kg	30
57	treg	Gozhde 4 cm e thjeshte	kg	30
58	treg	Gozhde 5 cm e thjeshte	kg	30
59	treg	Lame sharre seg	cope	10

60	treg	Gozhde 6 cm	kg	5
61	treg	Upa Ø10	pako	3
62	treg	Rondele Ø8	cope	490
63	treg	Upa	pako	3
64	treg	Vida strifoni	cope	300
65	treg	Strifoni 8x100	cope	300
66	treg	Kolle	kg	7
67	treg	Plasmas	cope	5
68	treg	Buke celesi	cope	2
69	treg	Spray	kuti	7
70	treg	Gur fresibel Ø330	cope	1
71	treg	Gur fresible Ø350	cope	1
72	treg	Fernell gazi	cope	2
73	treg	Fasheta	cope	4
74	treg	Pistoletë per perdorimin e silikonit	cope	2
75	treg	Vesh dryni	cope	5
76	treg	Buke celesi	cope	5
77	treg	Neft	kuti	3
78	treg	Punto kobalti Ø10	cope	2
79	treg	Dado + Bulona+Rondele	kuti	1
80	treg	Rondele Ø8	cope	490
81	treg	Tabela koshi 180*105*16 mm (e bardhe)	cope	2
82	treg	Bulona Ø8 gjatesia 10 cm + dado	cope	10
83	treg	Punto kobalti Ø8	cope	1
84	treg	Kolle	cope	20
85	treg	Rrula te vegjel per boje vaji	cope	20
86	treg	Boje hidromat	kg	1500
87	treg	Boje plastike	kg	350
88	treg	Furca Gelqere	cope	15
89	treg	Pigment gri (kuti metalike 180gram)	kuti	40
90	treg	Pigment e zeze (kuti metalike 180gram)	kuti	30
91	2.197	Leter katrama	m2	1200
92	2.197	Bitum m-3	kg	1560
93	2.197	Bitum m-5	kg	480
94	treg	Prajmer	litra	2400
95	treg	Vinovil	litra	4
96	treg	Bulona Ø8 gjatesia 5 cm + dado	cope	50

2. Materiale hidraulike

Nr.	Nr. Anl	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia
1	treg	Lavaman porcelani + kollone 50 cm	cope	2
2	treg	Kasete WC porcelani aksi 15 cm	cope	2
3	treg	Kasete WC plastike	cope	26
4	treg	Kapak WC me vakum	cope	18
5	treg	Galixhan bronzi 3/4"	cope	4
6	treg	Sifon lavamani me pilete	cope	77
7	treg	Mekanizem + Galixhan 1/2" Kasete porcelani dalje poshte	cope	23
8	treg	Mekanizem + Galixhan Kasete plastike	cope	14
9	treg	Tub fleksibel FF 5 cm 1/2 x 1/2	cope	15
10	treg	Tub fleksibel FF 70 cm 1/2 x 1/2	cope	8
11	treg	Tub fleksibel FF 70 cm 3/8 x 1/2	cope	7
12	treg	Saraqineske 3/4	cope	1
13	treg	Aks saraqineske Ø25	cope	2
14	treg	Saraqineske mishelatori 1/2 x 1/2	cope	13
15	treg	Rubinete Bronxi 1/2	cope	56
16	treg	Grup lavamani	cope	44
17	treg	Zgjatues 5 cm	cope	4
18	treg	Teflon i madh	cope	1
19	treg	Saraqineske Φ25 10 AT	cope	4
20	treg	Saraqineske Φ32	cope	4
21	treg	Tub fleksibel 50 cm M-F 1/2 x 1/2	cope	1
22	treg	Tub fleksibel 50cm M-F 3/8 x 1/2	cope	13
23	treg	Gomina 1/2"	cope	1
24	treg	Gomina 3/8"	cope	1
25	treg	Tubo shkarkimi Ø100 pvc	ml	21
26	treg	Fasheta metalike Ø100	cope	18
27	treg	Brryl pvc Ø110	ml	6
28	treg	Brryl pvc Ø100	ml	6
29	treg	Saraqineske 1" Hollande	cope	13
30	treg	Tapa Bronxi 1/2	cope	2
31	treg	Tub Ø20, PN 10	ml	15
32	treg	Rubinete bugati ose ekuivalent	cope	2
33	treg	Ti Ø22 10 atm	cope	2

34	treg	Lavapjate Inoksi	cope	1
35	treg	Grup Lavapjate	cope	1
36	treg	Tub Ø20	ml	66
37	treg	Xhunto 20*1/2 F-F	cope	1
38	treg	Bashkues Ø20, 3/4 10 atm	cope	3
39	treg	Bashkues Ø20, 1/2 10 atm	cope	10
40	treg	Brryl Ø100 45°	cope	4
41	treg	Brryl Ø20	cope	6
42	treg	Xhunto industriale Ø110	cope	1
43	treg	Galixhan anesore 3/8	cope	6
44	treg	Brryl Ø100	cope	6
45	treg	Brryl Ø110 90°	cope	1
46	treg	Brryl Ø20 1/2 10 atm	cope	2
47	treg	Saraqinesk Kolektori per kaldaja	cope	10
48	treg	Brryl Ø32 6 atm	cope	2
49	treg	Rekord Ø16 1/2 mashkull	cope	20
50	treg	Rekord Ø16 1/2 femer	cope	20
51	treg	Valvul dushi 1/2 10 bar	cope	4
52	treg	Bashkues Rekord Ø16	cope	5
53	treg	Tub Fleksibel 1/2	cope	15
54	treg	Rregullator uji	cope	3
55	treg	Selikon	cope	12
56	treg	Tub PN 10 Ø20	ml	15

3. Materiale elektrike

Nr.	Nr. Anl	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia
1	treg	Priza shuko 16A 220-240V GEWISS ose ekuivalent	cope	83
2	2.485/1	Celes 1P 10A GEWISS ose ekuivalent	cope	46
3	An	Suport 3P (Gewiss ose eq.)	cope	63
4	An	Kapak 3P (Gewiss ose eq.)	cope	47
5	An	Tap fallco (Gewiss ose eq.)	cope	91
6	treg	Llamba 12-18W, 230V, E27	cope	192
7	2.486	Portollambe E27, 10A e zeze	cope	71
8	2.483	Prize e thjeshte	cope	18
9	2.483	Celes 1P 10A	cope	39
10	An	Limitator Mag. Ter. 1P 20A	cope	13

11	An	Limitator Mag. Ter. 1P 25A	cope	19
12	treg	Spot katror LED mur 24W, 22.5x22.5cm	cope	21
13	An	Prize shuko 16A 220-240V (Biticino Luna ose eq)	cope	26
14	An	Celesa 1P 10A (Biticino Luna ose eq.)	cope	10
15	An	Celesa Biticiano inverter	cope	3
16	An	Celesa Biticiano Luna Deviat	cope	8
17	An	Celesa Gewiss Deviat	cope	10
18	treg	Neone 60 cm te bardha	cope	40
19	An	Suport 3P (Biticino Luna ose eq.)	cope	29
20	An	Tap fallco (Biticino Luna ose eq.)	cope	9
21	treg	Panel katror 59.5x59.5x1.2cm 40W	cope	33
22	treg	Pllafon 18 W i rrumbullaket	cope	3
23	treg	Mbrijtje diferenciale 3 fazore 40A	cope	2
24	treg	Kabell 3x 2,5mm2	ml	60

Afatet e lëvrimit:

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shënim:

- LOTI I: BLERJE MATERIALE NDËRTIMI 1,521,255 lekë pa Tvsh

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor kështu e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që garancia e mallrave do të jetë 1 (një) vit nga momenti i marrjes në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim si dhe ndërrimin në raste defektesh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre dhe se marrin përsipër furnizimin e mallit me kostot e veta në destinacionin e kërkuar dhe brenda afatit të levrimit dhe kërkesës të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor i cili duhet ta njoftoj autoritetin kontraktor 24 ore para dorëzimit të materialeve.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme), Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1.	Kamioncinë deri në 3.5ton	Në pronësi ose me qira	copë	1

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:
